


PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

Instalimi – Industritë energjetike

ID 1.7 “ Gaz natyror aromatik ose GNL, perveç rasteve kur veprimtaria eshte e lidhur me tipin A, ose perzierje e aromave”.

ID 1.10 “Furnizim me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane.



Rruga nacionale Fier-Vlore, fshati Levan, Njesia Administrative Levan, Bashkia Fier

Shoqeria “LAMÇE” sh.p.k
Administratori
Arjan LAMÇE

LAMÇE SH.P.K
NIP: K42523405F
0682081724
LEVAN FIER

Dhjetor 2025

TABELA PERMBLEDHESE

Hyrje	Error! Bookmark not defined.
1. VENDNDODHJA E OBJEKTIT.....	4
2. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT, PROCESET DHE LINJA TEKNOLOGJIKE	Error! Bookmark not defined.
3. VLERSIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS.....	Error! Bookmark not defined.
4. REKOMANDIME PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE.....	Error! Bookmark not defined.

Hyrje

Shoqeria “Lamçe” sh.p.k është një shoqëri vendase e regjistruar pranë QKB me Numer Nipt K42523405F me adresë selie Fier, Levan.

Shoqeria ushtron aktivitetin në perputhje me atë që është deklaruar në QKB: Import-eksport për tregtimin me pakice të karburanteve duke hapur një distributor në Levan të Rrethit të Fierit si dhe tregtimin e nënprodukteve të naftës si vajrave lubrifikante, gazit, furnizimin me energji elektrike të automjeteve elektrike, etj;

Ky raport, hartohet për veprimtarinë “**Pike karburanti dhe shitje gazi të lengshëm**” me qëllim pajisjen me leje mjedisore tipi B, sipas Vendimi i KM nr. 419, datë 25.06.2014, “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në leshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja, ndryshuar, kreu VI, “Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B”.

Subjekti “Lamçe” sh.p.k kërkon të pajiset me leje mjedisore tipi B sipas Shtojcës 1, të Ligjit Nr. 52/2020 për disa ndryshime në ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

Industrië energjetike

ID. 1.7 Gaz natyror aromatik ose GNL, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave.

1.10. Furnizim me karburanti makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane.

Qëllimi i hartimit të këtij raporti është të dokumentojë procesin e informimit dhe konsultimit me publikun në lidhje me aktivitetin e shitjes së karburantit dhe gazit të lengshëm, në perputhje me kërkesat ligjore dhe standartet mjedisore në fuqi. Raporti synon të sigurojë transparencë mbi proceset teknologjike, ndikimet e mundshme në mjedis dhe të mbledhë dhe analizojë shqetësimet dhe sugjerimet e publikut dhe paleve të interesuara.

Objektivat e këtij raporti janë:

- Te informojë procesin e vendim-marrjes duke identifikuar ndikimet e konsiderueshme potenciale në mjedis dhe rreziqet e perfitimet të projektit dhe zhvillimit të propozuar.
- Te promovojë zhvillimin e qëndrueshëm duke siguruar që propozimet e projektit nuk ndikojnë në funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesën e komunitet si dhe të njerezëve që lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

1. VENDNDODHJA E OBJEKTIT

Pika e karburantit dhe gazit te lengsem ndodhet ne te djathte te rruges nacionale Fier-Vlore, fshati Levan, Njesia Administrative Levan, Bashkia Fier.


Aktiviteti qe zhvillohet brenda koordinatave kufizuese te paraqitura me poshte, ndodhet ne pasurine nr. 414/21, Zk 2436, siperfaqe totale 4193 m², truall 1107 m², ndertesa : 331.1 m² e cila eshte ne pronesi te z. Arjan Lamçe me te cilin shoqeria ka nenshkruar kontrate qiraje per siperfaqen e mare ne shfrytezim.

Koordinatat sipas sistemit Gauss Kruger te truallit ku eshte instaluar impianti jane:

Nr	X (East)	Y (Nord)
Pika 1	4371276.97	4503887.33
Pika 2	4371258.82	4503924.68
Pika 3	4371271.14	4503928.90
Pika 4	4371258.20	4503970.28
Pika 5	4371267.13	4503973.29
Pika 6	4371267.73	4503971.51
Pika 7	4371283.22	4503976.71
Pika 8	4371289.99	4503958.26
Pika 9	4371301.64	4503954.79
Pika 10	4371315.57	4503945.29



PIKE KARBURANTI DHE SHITJE GAZI TE LENGSEM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

628628

Zyra e Regjistrimit FIER Zona Kadastrale Nr. 2436
 Numri i Pasurisë 414/21 Volumi 22 Faqe 96
 Adresa e Pasurisë FIER, LEVAN
 Lloji i Pasurisë ARE + TRUALL
 Sipërfaqja Totale 4193 M²
 Nga kjo : Sa Truall 1107 M² Nga kjo : Sa Ndërtesa 3311 M²
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>ARJAN</u>	<u>NAPOLON</u>	<u>LAMÇE</u>	<u>I</u>	<u>FIER, LEVAN</u>
/	/	/	/	/
/	/	/	/	/
/	/	/	/	/

- është pronar i PASURISË NR. 414/21
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart -
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi -
- kufizimet e pasurisë janë : V 414/19 , L 414/20 , J 450 , P 414/

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 13.11.12 Nr. 145

Data e lëshimit të çertifikatës

30.01.2013

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI

DILAYER KAMBERAJ



2. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT, PROCESIT DHE LINJA TEKNOLOGJIKE

Objekti “Furnizim me karburant dhe gaz i makinave” ndodhet ne ane te rruges nacionale Fier-Levan, fshati Levan, Njesia Administrative Levan, Bashkia Fier. Sheshi ne te cilen ndodhet objekti, shtrihet ne nje terren te rrafshet, ndersa prona eshte e karakterizuar nga nje siperfaqe uniforme ku efekti i erozionit nuk eshte i ndjeshem.

Pika e karburantit eshte nje ndertim bashkohor si nga ana vizuale, ashtu dhe nga ana funksionale. Invenstitori ka bere rregullime, sistemime te sheshit para objektit, rrugeve duke bere te mundur aksesnin e autoboteve per furnizimin e depozitave me karburant e gaz si dhe aksesin e automjeteve per furnizimin e tyre me karburant dhe gaz te lengshem.

Instalimet, pajisjet dhe depozitat jane konform standarteve te kerkuara, te importuar per kete qellim. Ne piken e karburantit dhe te gazit te lengshem duke qene se kemi te bejme me lende te djegshme ekzistojne te gjitha paisjet e mbrojtjes nga zjarri dhe punonjesit jane te instruktuar konform legjislacionit per kete qellim.

Pika e karburantit ka kapacitet projektues te naftes dy depozita 36000 litra, benzina 10200 litra dhe gazi 5000 litra.

Per sa i perket fuqise puntore ajo perbehet nga 4 punonjes te cilet sherbejne ne sektorin e shitjes se karburantit.

Produkti qe shitet ne kete pike karburanit eshte **nafta, benzina dhe gazi i lengshem.**

Karakteristikat e lendes se pare qe shiten jane:

NAFTA

- Densiteti ne 20 °C 0.837 gr / cm³
- Densiteti ne 15 °C 0.848 gr / cm³
- Fillimi i vlimit 175 °C
- Vlone deri ne 250 °C , perqindja e vol – 46 %
- Vlone deri ne 350 °C , perqindja e vol – 96 %
- Vlone deri ne 370 °C , perqindja e vol – 50 %
- Aciditeti total 0.02 mgr KOH / gr
- Viskoziteti kinematik ne 400 °C 2.2 est
- Koksi Conradson (10 % te mbetjes se distilantit 0.02)
- Permbajtja e hirit 0.02 % / m
- Permbajtja e sqfurit 0.02 % / m
- Temperatura e flakerimit 157 °C
- Permbajtje e ujit : nuk ka
- Mbeturina mekanike : nuk ka
- Korozioni ne baker (3 ore ne 50 °C) reziston
- Temperatura e ngritjes – 10 °C

BENZINA

- Densiteti ne 20 °C 0.723 gr / cm³

- Numri i oktanit , metoda motorike -54
- Fillimi i vlimit ne temperaturen eshte ne 69 °C
- 10 % distilohen ne temperaturen 86 °C
- 50 % distilon ne 113 °C
- 90 % distilon ne 148 °C
- Mbarimi i vlimit ne temperaturen 170 °C
- Mbetjet pas distilimit 1.5 %
- Humbje + mbetje 3.5 %
- Permbajtja e squfurit 30 ppm
- Permbajtja e plumbit 1.9 ppb
- Prova e pllakes se bakrit reziston
- Aciditeti organik ne mg kohe / 100 ml benzine 0.7
- Acide dhe baza te tretura ne uje neutrale
- Reshirat faktike ne mg / 100 ml benzine -
- Papasteri mekanike + uje -
- Numri i bromit G. Brom / 100 g benzine 1.2

GAZI LENGHEM (GLN)

1. Gazi i lengezuar i naftes (GLN)

Gazi i lengezuar i naftes, si term i pergjithshem, paraqet lenden djegese te gazte te perbere nga hidrokarbure me 3 ose me 4 atome karboni dhe te kthyer ne gjendje te lenget. Ne gjendjen agregate te lenget, sic perdoren ata, zene vetem 1/250 e vellimit qe do te zinin ne gjendjen agregate te gazte. Ky tregues e bene mjaft praktike depozitim dhe transportimin e kesaj lende djegese. Perdorimi i sotem i pergjithshem industrial dhe komunal evidenton dy lloj gazi te lengezuar, butanin (C₄H₁₀) dhe propani (C₃H₈), si dhe perzietjen e tyre. I kushtezuar nga vetite termodinamike te tyre (vlojne ne temperatura te ulta, butani -0.5 °C, propani ne -42.1 °C), depozitimi ne gjendje te lenget ne temperature e mjedisit (qe eshte me praktike) realizohet shume mire dhe me presione te zakonshme. Perdorimi i gazit te lengezuar, tani po zgjerohet gjithnje e me shume. Ne Shqiperi, nga viti 1999, ai eshte gati shumefishuar.

2. Cilesit e gazeve te lengezuar

Gazi i lengezuar eshte pa ngjyre dhe ndikon pak ne ndotjen e ambientit. Ne kete gjendjen, ai paraqitet me i rende se ajri: masa molare e butanit eshte 58.1 kg/mol, me densitet ne kushte normale 2,593 kg/m³ N (dy here me i rende se ajri) dhe e propanit 44,09 kg/mol, me densitet ne kushte normale 1,968 kg/m³ N. Si rjedhoje e kesaj vetie keto gaze njedhin ne siperfaqen e tokes e neper kanalizime dhe duke u grumbulluar ne kuotat me te ulta te terrenit, kerkojne kohe per tu larguar. Gazi i lengezuar, kur ndodhet ne ajer me perzierje te caktuar (2-1 0%), krijon kushte eksplozive. Kontrolli i pranise se gazit ne mjedis, si mase e domosdoshme ne marjen e masave paraprake per shmangien nga ky rrezik, behet me aparatura te posacme. Per kete disiplina teknike ne ndertimin dhe

shfrytezimin e impianteve te ketij lloji eshte e padiskutueslune. Tek njerezit gazi i rjedhur shkakton anestezi te lehta dhe madje deri ne asfiksi.

Perzierjet e padeshiruara te ajrit me gazin e rjedhur prej mos hermetizimit te pajisjeve, behet shkak per djegie ne distance. Nepermjet nuhatjes, zbulimi i gazit eshte i mundur eclhe ne nivele te ulta te grumbullimit te tij, madje deri me pak se 1/5 e kufirit te poshtem te eksplodimit (afersisht 0.4% ne vellim te gazit te ndodhur ne ajer). Shenja te tjera mbesheten ne vetite termodinamike te gazit. Temperaturat e ulta te vlimit te gazit te lengezuar (me poshte se temperaturat e zakonshme te ajrit) bejne qe kur ai kalon ne ajer te mundesoje formimin e veses nga avujt te ndodhur ne kete te fundit. Po keshtu, nga avullimi i shpejte i gazit i ndodhin deri ne demtime serioze te lekures se njeriut. Per te gjitha keto arsye, perdoruesit e gazit te lengezuar duhet te pajisen edhe me mjete mbrojtese. Ne perdorimin e gazit te lengezuar duhet te kihet kujdes edhe me enet e boshatisura prej tij . Ato mund te mos jene te shkarkuara plotesisht. Nese valvola e tyre ka rjedhje ose lihet e hapur, ajeri i futur ne ene mund te krijojte perzierje eksplozive.

3. Vetite fizike te gazit te lengezuar te naftes

Per perdorim efikas te gazit te lengezuar te naftes ne kushtet industriale dhe komunale, eshte e domosdoshme qe perdoruesi te kete informacion sa me te plote mbi vetite fizike te tij . Treguesit perkates te vetive te gazeve te lengezuar jane rezultat i madhesive mesatare te dala nga prodhimi i tyre prej uzinave dhe rafinerive perkatese.

Tabela 1 Treguesit fizike te gazeve te lengezuar

Nr.	Tregues fizike	Njesia e matjes	Gazi i lengezuar	
			Butan	Propan
1	Presioni i avullit ne:			
	t=20 °c	kPa	103	895
	t=40 °c	kPa	285	1482
	t=50 °c	kPa	345	1672
	t=55 °c	kPa	462	1980
2	Densiteti ne temp.15.5 °C	Kg/m ³	0.582	0.504
3	Temp. e vlimit per p-1 bar	°c	-9	-42
4	Nxehtesia specifike per 15.56 °C.	Kj (kgK)	1,276	1,464
5	Vellimi i gazit per liter leng ne 15.56 °C	m ³	0,235	0,271
6	Densiteti i lengut ne temp 15.5 °C	kg/m ³ N	2,593	1,968
7	Raporti densitetit te gazit ndaj atij te ajerit		2.01	1,50
8	Temperatura e vetendzjes ne ajer	°c	482-538	493-549
9	Temperatura maksimale e flakes	°c	2008	1980
10	Kufijte e marjes flake ne ajer	°c	1,55-8,60	2,15-9,60

PROJEKTIT TEKNOLOGJIK

Stacioni i karburantit




Foto 1 Stacioni i karburantit

Stacioni i furnizimit me karburant dhe gaz te lengshem perbehet nga:

- ✓ Dhoma e operatorit 10m²
- ✓ Zona e furnizimit (pompat)
- ✓ Zonat e depozitave (karburant dhe gaz)
- ✓ Sistemi i mbrojtjes nga zjarri
- ✓ Zona e parkimit
- ✓ Zona e gjelberimit

KARBURANTI

- ✓ **Dhoma e operatorit (zyra)**

Dhoma e operatorit me nje siperfaqe 10m² është një nga pjesët më të rëndësishme të stacionit te shitjes karburantit dhe gazit te lengshem. Kjo është hapësira ku personeli kryen të gjitha funksionet e kontrollit te pajisjeve te furnizimit, menaxhon pagesat, monitoron sigurine dhe administron dokumentacionin e stacionit te furnizimit.



Foto 2 Dhoma e operatorit (zyra)

✓ **Zona e furnizimit (bazamenti i pompave)**



Foto 3 Bazamenti i pompave

Pompat per furnizimin me nafte dhe benzine jane vendosur mbi bazament betoni. Gjeresia e bazamenteve te pompave eshte 1 m. Lartesia mbi bazen e sheshit eshte 20 cm, kurse gjeresia e tyre 3 m. Marka e betonit eshte 150.

Ndertimi i bazamentetve behet per te siguruar sherbim te mire te instalimit nga pikepamja funksionale.

Bazamenti i pompave eshte mbuluar me strehe sipas projektit funksional me fushpamjen nga rruga dhe lartesi 5 metra te futur brenda objektit me ndricim te mjaftueshem jo verbues per automjetet qe do te vijne per tu furnizuar me karburant. Bazamenti i pompave eshte bere me material jo rreshqites per te punuar lirisht.

Instalimi dhe funksionimi i dhenies se karburantit ploteson kushtet e meposhteme:

- Dhenia e karburantit behet ne litra dhe te kontrollueshme ne çdo kohe .
- Sasia e dhenies i pergjigjet tregtimit te regjistruar nga eksperti i pompes me debit mates te taruar.
- Montimi i paisjeve dhenese (pompat, tubo gomat, pistoletat, etj) sigurojne hermetizim te plote pa lejuar rrjedhje te karburantit.
- Elektromotori i pompes eshte i tipit hermetik dhe me rotor me lidhje te shkurter.
- Instalimi elektrik i pompes eshte hermetik dhe i sigurte ne menyre qe te evitohet futja e avujve te karburantit.
- Eshte paisur me tregues te rrjedhjes se karburantit i cili duhet te jete i plote para dhe pas dhenies dhe te shenuar ne tabelen e vendosur ne tregues.
- Eshte i paisur me valvol moskthimi ne thithje te linjes se pompes.
- Eshte i paisur me mekanizmin e fshirjes se leximit te meparshem i cili pengon dhenien e karburantit po nuk u kthye ne 0.00 .
- Hedhesi, pistoleta funksionon me valvol te dyfishte me dore dhe me presionin e pompes.
- Dhenesi siguron boshatisjen e karburantit ne hapsirat pomp – hedhese (pistolete) .
- Sigurohet ajrosja brenda karkases se pompes.
- Garanton dhenien e sakte te prurjes se pompes nepermjet valvolave speciale prej plumbi te pa prekura.
- Pompa eshte e paisur me ndricim te saj per te pare ne çdo kohe treguesin e sasise.
- Pompa ka tabelen e vendosur ne te ku shkruhen fabrika e prodhimit, karakteristika e pompes dhe sasia e prodhimit .
- I gjithë agregati i pompes eshte i mbuluar me karkase metalike.

✓ **Zonat e depozitave (depozitat nentokesor te stacionit)**

Ne kete stacion ndodhen 3 depozita, dy depozita nafte me kapacitet 36000 litra secila dhe nje depozite benzine me kapacitet 10200 litra.

Keto rezervuare jane te instaluar nene toke dhe ndodhen mbrapa godines se lokalit dhe zyres teknike.

Depozitat jane prej llamarine celiku te bute dhe te pregatitur me saldim. Forma e tyre eshte cilindrike (ndalohet perdorimi i depozitave me faqe te rrafsheta) . Trashesia minimale e llamarines eshte 5 mm.

Depozitat jane te paisur me kapak (bakaport) te mbyllur me bullona per te lejuar hapjen e tyre per kontroll. Ne kapakun e bakaportes eshte vendosur pllaka me shenimet, prodhimi, viti i prodhimit, permasat dhe kapaciteti i depozites. Ato jane te lyer nga jashte me material antikoroziv dhe te veshur me material hidroizolues per tu mbrojtur nga korozioni nentokesor.



Foto 4 Rezervuar nentokesor

Vendosja e depozitave nen toke

- Depozitat jane vendosur ne menyre te tille qe pika me e larte e grykes se rezervuarit te jete minimumi 0,5 m e mbishtreses mbi rezervuar.
- Depozitat jane vendosur mbi nje bazament te perbere nga 3 jastek betoni marka 200.
- Depozitat jane vendosur ne nje distance rreth 1.2 meter larg njera - tjeters. Kjo hapsire eshte mbushur me inerte dhe ne siperfaqe eshte mbushur me rere te ngjeshur.
- Mbi çdo depozite jane vendosur bokaportat ne te cilat jane vendosur aksesoret ndihmes te saj.
- Depozitat nuk kane komunikim atmosferik, kjo realizohet me anen e tubove te ajrimit, diametri i te ciles eshte minimumi $\Phi = 2''$ dhe perfundon me nje lartesi 2,8 m ku kokat e tubove dalin dhe kthehen nga poshte ku ne koke kane rrjete mbrojtese.
- Depozitat metalike jane tokezuar para lyerjes per mbrojtje nga korozioni si dhe u eshte bere kontrolli periodik per te verifikuar hermecitetin e tyre. Ne lidhjen me tokezimit jepet qarte ne skemen qe i korespodojne kesaj pjese. Kapaciteti maksimal i dy depozitave te naftes eshte 36 000 l, i depozites se benzines 10200 litra, depozita me hapsire boshlleku 10 % mbi volumin e punes.

Kushtet qe plotesojne tubacionet dhe linjat e tjera qe lidhen me depozitat

- Te gjitha tubat jane me material te paoksidueshem, ndalohet perdorimi tubove te zeza. Lidhesit e tubacioneve kane konstruksione dhe cilesi te pershtateshme, konkretisht prej inoksi.
- Tapat e hermetizimit te daljeve nga rezervuari jane me material bronxi, alumini apo bronxi qe te evitohen shkendijat gjate hapjeve dhe mbylljeve si dhe nga korozioni qe shkakton karburanti.
- Tapat e hermetizimit te daljeve nga rezervuari vendosen me filetimit ose hermetike me konicitet.

PIKE KARBURANTI DHE SHITJE GAZI TE LENGHEM




Figure 1 Planvendosja e stacionit te karburantit

Formulari R 004 . Vërtetim për matje vëllimi rezervuari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË
DREJTORIA E METROLOGJISË LIGJORE

Nr. 55 Prot.

Tiranë, më 26 . 11 . 2020

VËRTETIM
(për matje vëllimi rezervuari)

Vërtetojmë se Z. Arjan Lamçe ... pronar (përfaqësues) i firmes Lamçe Shpk.....me vend – ndodhje... Fier, Levan ka kryer pranë DPM-së :

1. Shlyerjen e të gjitha detyrimeve ligjore në lidhje me paisjet metrologjike
2. Matjen e vëllimit (përcaktimin e kapaciteteve) të rezervuarëve cilindrike të tipit vertikal/horizontal mbi/nën tokësorë me vend ndodhje Fier, Levan si vijon:
 - Rezervuar tip Cilindrik Horizontal me volum 36000 litra (nr. certifikate 119)
 - Rezervuar tip Cilindrik Horizontal me volum 36000 litra (nr. certifikate 120)
 - Rezervuar tip Cilindrik Horizontal me volum 10200 litra (nr. certifikate 121)

duke marrë dhe certifikatat përkatëse bashkangjitur.

Shënim: Ky vërtetim nuk është i vlefshëm për tu përdorur për zbatimin e dispozitave të ligjit Nr. 61 datë 24.05.2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Petrit Rama



INSTALIMI I GAZIT

Te dhenat e impiantit

Karakteristikat e depozites se gazit

- Depozita e gazit eshte e llojit A. Merloni me NF48772, kapacitet 5000 litra, $p=17.6$ bar e vendosur nëntokë e projektuar për ruajtje nëntokë të gazit të lëngshëm LPG. Ajo eshte e certifikuara sipas standardeve evropiane për rezervuarë presioni dhe të përshtatshme për përdorim në pikat e karburantit.
- Depozita ka forme cilindrike, me perberje çelik i trashë rezistent ndaj presionit, e lyer me material antikorrozive, plotesisht i zhytur nentoke dhe i pajisur me kapak kontrolli ne siperfaqe.
- Depozita eshte fiksuar ne grope me bazament betoni e cila duron shtytjet hidrostatike.
- Ne siperfaqe ne kapakun e kontrollit depozita eshte pajisur me valvul sigurie, tregues te nivelit te lengut, pajisje bllokimi te mbushjes mbi nivelin e lejuar, manometer, termometer, valvol te rrikthimit te teprices.
- Depozita eshte e pajisur me sistemin e tokezimi te sigurt dhe te kontrolluar.
- Instalimi eshte i pajisur me prize per lidhjen e tokezimit te autocisternes me depoziten.
- Instalimet elektrike jane kryer konform ligjeve ne fuqi dhe kontrollohen periodikisht.
- Instalimi eshte i pajisur me ndricim te mjaftueshem.
- Tubacionet e G.L.N jane prej çeliku per tu mbrojtur nga goditjet aksidentale dhe kane elasticiteti ne rast zgjerimi dhe tkurje. Jane projektuar per presion 40 bar.
- Tubacionet e furnizimit te autogazit jane fleksibel dhe rekorde te lidhjes se shpejte, me presion 30bar.
- Autogazi eshte i pajisur me pajisje te sistemit te mbrojtjes ndaj zjarrit.
- Pompa dhe linja e G.L.N kane valvola sigurimi dhe lidhje elektrike sipas normave.

Distancat e sigurise se instalimit te rezervurit jane:

- Nga autostradat deri 30 m, ne rruge te tjera deri 15 m
- Nga linjat e tensionit mbi 380 volt minimumi 15 m
- Nga zyrat dhe nga ambjentet e sherbimit 10 m
- Dhoma e drejtuesit 20 m
- Lokalet e ngrënies dhe sherbimit 20 m
- Nga parking minimumi 10 m
- Midis rezervuareve te karburanteve 10 m
- Midis aparateve te karburantit dhe G.L.N minimumi 5 m

Per perdorimin sa me te sigurve te impiantit te furnizimit me GLN te automjeteve eshte e domosdoshme qe nga personeli perdorues te njihet mire skema e fluksit dhe regullat e shfrytezimit, te sigurimit teknik dhe te mbrojtjes nga zjarri te cilat pershkruhen me poshte:

Formulari R003 - Çertifikata e Matjes së Vëllimit të rezervuarëve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË
 DREJTORIA E METROLOGJISË LIGJORE
 SEKTORI I SHERBIMIT NR.2...

Nr. 56 Prot.

Fier, më 26.11. 2020

ÇERTIFIKATË nr 122

PËR MATJE VËLLIMI REZERVUARI

Kërkuesi	Arjan Lamçe
Emri i shkurtuar	Lamçe Shpk
Vëndi nga dërgohet kërkesa	Fier, Levan
Nr.prot. kërkesës	56.....
Data e kërkesës	23.11.2020.....
Tipi i rezervuarit	Cilindrik Horizontal.....
Rezervuari me indeks (numër)	R1...GLN.....
Prodhuar nga	Shqiperi.....
Vendndodhja	Fier, Levan.....
Principi i matjes	R006/3.....
Temperatura e matjes	Normal.....
Data e matjes (verifikimit)	24.11.2020.....
Data e lëshimit të çertifikatës	10.12.2020.....

Mbeshtetur në formularin e matjeve Nr. R006/3-1..... , datë ...24/11/ 2020..


Vëllimi i rezervuarit rezulton 5000 (Pesëmijë) Litra

Metrologu i zonës nr.5...

Metrologu i Sektorit të Shërbimit nr.2...

(Besiana Ymeraj)

(Izmir Banushaj)

Autostrada Tirane-Durres, Km.8, Kashar, Tirane Web: www.dpm.gov.al Email: metrology@dpm.gov.al

MASAT PER MBROJTJEN NGA ZJARRI

Duhet te pajisen me mjete per mbrojtjen nga zjarri ne menyre qe:

- Te kontrollohet dhe dallohet shpejt fillimi nje zjarri.
- Te ftohen ne rast zjarri rezervuaret, bombolat etj.
- Te shmanget perhapja e zjarrit.
- Te realizohet hollimi ne ajer i rrjedhjeve te mundshme te G.L.N
- Te pajisen me fikset e zjarrit te dares te pershtatshme.

Personeli qe punon ne keto impjante duhet te kete mbushur moshen 18 vjec dhe ti behet instruktim fillestar dhe periodik te pakten dy here ne vit.

SHFRYTEZIMI IMPIANTIT

- Te behet kontrolli bombolave para dhe pas mbushjes sipas standartit STASH EN 1439
- Bombolat duhet te mbushen me G.L.N me cilesi te larte sipas standarteve te B.E qe mos te shkaktojne korrozion.
- Bombolat duhet te jene te lyera dhe brenda afatit te kolaudimit.
- Ndalohet absolutisht dhenia e bombolave qe kane rrjedhje, sado te vogla qofshin ato.
- Per cdo bombol dorezohet dhe udhezuesi perdorimit.

FURNIZIMI REZERVUARIT

- Futet automjeti cistern ne zonen e qendrimit ne kushte te sigurta qe ne rast rreziku te largohet menjehere.
- Skapamentua te jete e pajisur me flakeprites.
- Te kufizojte zonen rreth autocisternes
- Te lidhet pinceta e tokezimit te automjetit me tokezimin e rezervuarit.
- Te hapen tubot e shkarkimit te lidhen rekordet e autocisternes me rezervuarin
- Kontrollohet hermeticiteti e fillon mbushja e rezervuarit.
- Kontrollohet vazhdimisht mbushja dhe ndalet furnizimi pak para se veje
- niveli maksimal {85%}.
- Mbyllet saraqineska ne autocisterne e behen gradualisht shkeputjet e te gjitha lidhjeve te realizuara.

MASAT NE RAST ZJARR

Zjarri mund te zhvillohet vetem ne rast se ka rrjedhje te G.L.N.

Burim i ndezjes mund te jete elektriciteti statik (ferkimi shtresave te lengut), flaka e lire, cigare, impjantet elektrike, shkendijat nga perplasjet ose thyerjet, pikat inkandeshente. Ne keto raste:

- Nderpritet distance operacioni mbushjes se rezervuarit.
- Te mbyllet ventilat per zvogelimin e rrjedhjes se gazit.
- Lajmerohet P.SH.M.N.Z
- Largohen njerezit.
- Largohet automjeti
- Ftohen pajisjet qe mbajne G.L.N

MASAT MBROJTESE NGA ZJARRI

1. Vetite e gazit te lengezuar te naftes
 - Eshte asfiksues ne perqindje te larta
 - Eshte i djegeshem
 - Eshte eksplodues ne kufirin e koncentrimet(2-10)Y.
2. Ne kushtet normale gazi i lengezuar i naftes nuk mund te ndizet.
3. Zjarrmaja (ndezja) behet ne rastet e prezences se flakes se hapur ose shkendijave te mundeshme qe mund te krijohen .
 - Gozhdet e kepuceve, goditjet metalike, perdorimi veglave te papershtatshme te punes(celsat duhen Bronx ose celiku me faqe bronxi).
 - Shkendijat elektrike te krijuara, linjat elektrike, celularet ose paisjet shtepijake.
 - Prirja e duhanit.
4. Keto ndodhin zakonisht ne zonen e rrezikshme, kjo zone perfshin nje distance prej 15m nga rezervuari.
5. Duhet te theksojme qe avujt e G.L.N jane me te renda se ajri dhe çdo rrjedhje vendoset ne pjeset e poshtme te ambienteve te punes.


Per kete qellim vendosen mjetet per shuarjen e zjarrit.

Perdoren rreth 5 fikse me pluhur 8-10 kg. ose nje fikse e madhe 50 kg te shperndara ne vendet me te pershtatshme.

- Mbushja e rezervuarit lejohet 80% ne vere 85% ne dimer.
- Ndalohet manovrimi ose prehja e aksesoreve te matjes e sigurise.
- Furnizimi i rezervuarit behet nga punonjes se specializuar dhe nuk duhet harruar lidhja e autobotit me tokezirnin e rezervuarit.
- Ndalohet lenia e impjantit te gazit pa mbikqyrje.
- Kur ka nevojë ne periudhen e veres rezervuari freskohet me ane te ujit.

Gjithmone gazi ka te papritura, respektoni cdo rregull teknik pasi pasojat jane te paparashikueshrne.

PIKE KARBURANTI DHE SHITJE GAZI TE LENGSIHEM



PLANIMETRIA E DEPOZITES C.L.N.

POROSITËS ... LAMCE SH.P.K. ... L. EVAN ... FIER
 Objekte industriale, teknologjike, Furnizim me gaz, avull, uje te zbutur, M.N.U.
 Ektor Projekt
 0894011424, 0693073595
 Shteteve te Bashkuara te Amerikes, 10000
 Projektim, Zbatim, Supervizim, Kollaudim. M00012, M00022

PIKE KARBURANTI DHE SHITJE GAZI TE LENGHEM

Lendet e para:

- ✓ Naftë
- ✓ Benzin
- ✓ Gaz i lengshem

Lendet ndihmese:

- ✓ Energji elektrike (meret nga rrjeti kryesor shperndares elektrik i Njesise Administrative
Levan)
- ✓ Uje (meret nga rrjeti kryesor i furnizimit me uje te pijshem i Njesise Administrative
Levan)

3. VLERSIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Ndikimet negative ne mjedis nga aktiviteti qe ushtrohet vleresohen ne menyre te pergjithshme ne kete raport. Ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin te cilat lidhen me aktivitetin e tregtimit se bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

- **Shkarkimet ne uje**

Gjate zhvillimit te aktivitetit te magazinimit dhe tregtimit te karburantit dhe gazit, nuk kemi shkarkime te ujrave te gjeneruara ne ujrat siperfaqesor. Ujrat qe gjenerohen nga ambientet higjeno-sanitar grumbullohen ne gropen septike te ndertuar nga shoqeria sipas kushteve teknike. Gropa septike pastrohet periodikisht nga kompanit e licencuara per trajtimin e ujit te ndotur. Ujrat e pastrimit te ambjenteve te aktivitetit dhe te shiut nepermjet pjerese se sheshit orientohen drejt kanalit kullues te ujrave te bardha te zones. Keto ujra nuk kane prani te karburantit pasi subjekti eshte shume i kujdesshem ne magazinimin dhe tregtimin e tyre duke shmangur me rigorozitet rrjedhjen e tyre ne sheshet e ambjenteve te aktivitetit. Ne rastin e rrjedhjeve aksidentale te karburantit ne sheshet e ambjentit te aktivitetit, menaxhimi i tyre do te behet nepermjet hedhjes se reres mbi siperfaqen e derdhur te karburantit. Rera e perzier me karburant do te hidhet ne fuci dhe prej andej do te transportohet drejt firmave te tregtimit te tyre. Nga derdhja aksidentale nuk kemi depertim te tyre ne ujrat nentokesore pasi sheshi eshte i shtruar me beton dhe pllaka betoni.

- **Emetimet ne ajer**

Nga proceset e magazinimit e furnizimit me karburant dhe gazit, kemi gjenerimit te gazrave dhe avujve te demshem te cilat jane tipike per procese te tilla pune per ruajtjen e tyre. Gjate proceseve te furnizimit me karburant dhe gaz te depozitave, furnizimit me karburant te automjeteve tek pompat, ne bakaportat e depozitave do te kemi emetime VOC (komponime organike te paqendrueshme) qe avullojne lehtesishte ne ajer ne temperatura normale. Nga ardhja dhe largimi i automjeteve ne ambientet e karburantit do te clirohen CO₂, NO_x, PM, CO nga djegja e karburantit ne motoret e tyre. Gjithashtu te pranishme ne terminallet e shkarkimit ne varesi nga cilesia e karburantit mund te kemi dhe shkarkime te SO₂ te cilat jane te pashmangshme edhe pse shoqeria ka marre masat e nevojshme per reduktimin ne maksimum te ketyre shkarkimeve. Ne rastin e rrjedhjeve aksidentale subjekti ka mar masa per menaxhimin e rrjedhjeve nepermjet teknikave me te mira per shmangjen maksimale te ndotjes se ujrave nentokesore.

- **Ndikimet ne toke**

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do te kemi ndikime ne toke pasi sheshi i ambjenteve te magazinimit dhe tregtimit me karburant dhe gaz, eshte i shtruar me pllaka betoni duke shmangur depertimin e karburantit ne rast aksidentesh ne shtresat e tokes. Per sa i perket mbetjeve qe gjenerohen nga aktiviteti jetesor i punetoreve, grumbullimi i tyre dhe diferencimi behet nepermjet sistemit te koshave te vendosur ne ambientet e aktivitetit.

- **Zhurmat dhe vibrimet**

Zhurmat qe gjenerohen ne mjedisin ne fjale, vijne kryesisht nga procesi i shperndarjes dhe magazinimit te karburantit dhe gazit. Keto zhurma gjenerohen nga motoret e automjeteve dhe autoboteve qe vijne dhe largohen ne ambientet e karburantit, hapja e kapakeve te depozitave, pompat e furnizimit, etj. Zhurma jane momentale deri ne perfundim te magazinimit dhe furnizimit te automjeteve me karburant.

Vleresimet per zhvillimin e aktiviteve te tilla, rezultojne se gjenerimi i zhurmave eshte ne nivele mesatare te lokalizuara brenda zones se aktivitetit dhe arrijne maksimumet e tyre kur vijne autobotet e furnizimit te depozitave. Vibrimet do te gjenerohen nga levizja e automjeteve te renda (autobotet e furnizimit te depozitave) dhe automjetet e renda qe do te furnizohen ne karburant. Keto do te jene gjenerime te perkoshme.

- **Ndikimet ne flore/faun**

Aktiviteti zhvillohet brenda konturit te siperfaqes se aktivitetit duke mos ndikuar aspak ne floren dhe faunen e zones. Perkundrazi ne konturet rrethuese te prones rekomandohet te mbillet nje brez me bimesi te llojit lejelander per te mbrojtur zonen perreth nga pluhurat, zhurmat, rritjen e cilesise se ajrit, permiresimin e pejsazhit, ndarjen e ambientit te aktivitetit nga zona perreth, etj.

- **Mbetjet e prodhuara**

Mbetjeve qe gjenerohen nga ky aktivitet jane mbetjet nga aktiviteti jetesor i punetoreve te kalsifikuara si mbetje urbane, grumbullimi i tyre behet nepermjet sistemit te koshave te vendosur ne ambientet e objektit dhe prej andej do te transportohen ne menyre periodike drejt vendgrumbullimit me te afert te mbetjeve urbane.

4. MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT

Masat e propozuara per funksionimin eficient dhe te sigurt te punes ne aktivitetin e tregtimit te karburantit:

- ✓ Te mirembahen mjediset e gjelberuar ne menyre te perhershme dhe te mbillen edhe bime dekorative autoktone ne kushte artificiale per te rritur koeficientin e gjelberimit.
- ✓ Te shmanget ne maksimum perdorimi i mjeteve te transportit kur nuk eshte e nevojshme dhe te reduktohen zhurmat ne oret e vona.
- ✓ Te kryhet rrethimi i objektit dhe linjes se depozitimit te karburanteve dhe te vendosen tabela paralajmeruese per rreziqet per kalimtare dhe punonjesit.
- ✓ Te reduktohet qarkullimi ne oret e pikut te trafikut, per te mos krijuar trafik te renduar ne zone.
- ✓ Te mos perdoren borite e mjeteve ne qendrat e banuara dhe qarkullimi te kryhet me shpejtesi te ulet.
- ✓ Te vendosen kontenier per mbajtjen paster te ambienteve nga mbetjet urbane per numrin e punonjesve.
- ✓ Mbetjet e rrezikshme me permbajtje hidrokarbure te rikuperohen dhe asgjeshohen nga subjekte te licencuara.
- ✓ Investitori te respektojte detyrimet e vendosura ne Lejen Mjedisore qe do te miratohet nga AKM.
- ✓ Subjekti te respektojte te gjitha masat/normat/planet/shkarkimet qe do te deklarohen ne formular-Kerkese per Leje Mjedisore Tipi B.
- ✓ Subjekti te jete ne dijeni dhe te azhurnohet per kuadrin ligjor per mjedisin dhe ndryshimeve te tij.
- ✓ Subjekti te respektojte dhe zbatojte kushtet teknike ne objekt per mbrojtjen nga zjarri dhe te krijojte infrastrukturen e nevojshme per zjarrefikset.
- ✓ Te kryhet monitorimi i indikatorëve te mjedisit sipas ligjeve ne fuqi.
- ✓ Eshte detyre e zbatuesve te projektit te integrojne elementet e domosdoshem te propozuar per parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative ne mjedis, shendet dhe aspektin social.
- ✓ Eshte detyre e Njesise Vendore gjithashtu te zbatojte rigorozisht detyrimet e percaktuara per te garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit.
- ✓ Eshte detyre e te gjith kontraktoreve e nenkontraktoreve te ndryshem si gjate fazes se depozitimit te karburanteve te zbatojne me kujdes detyrimet perkatese te parashikuara me siper.

Masa lehtesuese te kerkuara

- ✓ Do te behet nje menaxhim sa me me eficient te energjise elektrike, kjo do te coj ne uljen e ndotjeve termike te mikroklimes se zones si dhe kursim te energjise elektrike nga perdorimi i makinerive/impianti me eficence.

PIKE KARBURANTI DHE SHITJE GAZI TE LENGSIEM

- ✓ Percaktimi i vend-parkimit te automjeteve si dhe paisja e vend-parkimeve me sinjalistiken perkatese.
- ✓ Subjekti te kryej aktivitetin per shperndarjen dhe magazinimin e karburantit vetem brenda kordinatave te siperfaqes se tokes qe disponon ne zoterim.
- ✓ Do te kontrollohen kushtet teknike te mjeteve te punes ne menyre periodike per te evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve ne mjedis, emetimin e gazeve dhe zhurmave te teperta te shkaktuara nga avari te mundshme teknike te mjeteve.
- ✓ Linja e impiantit te instaluar ne objekt, do te koluaudohet ne menyre periodike nga teknike te specializuar dhe çertifikuar per te tilla procese.
- ✓ Veglat/Pajisjet/Makinerite e punes qe sherbejne per procese te ndryshme do te zevendesohen me te reja, sipas jetegjatesise se tyre dhe eficences qe kane ne kryerjen e operacioneve depozitimit te karburanteve.
- ✓ Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet ne zonen e shfrytezuar do te lyhet periodikisht me boje higjenike dhe antikorrozive, me qellim plotesimin e kushteve Higjeno-Sanitare.
- ✓ Do te behet menaxhimi i mbetjeve te ngurta te klasifikuara si mbetje urbane, te cilat perfshine; amballazhe, letra/kartona, si dhe lende organike te prodhuara nga punonjesit dhe klientat. Keto mbetje do te grumbullohen nepermjet koshave plastik te vendosur ne ambientet e aktivitetit dhe do te transportohen rregullisht ne vendin e caktuar nga Njesia Vendore.
- ✓ Do te behet pastrimi periodik i rrjetit te drenazhimit te ujrave te pastrimit dhe ujit te shiut ne kete objekt ose e mjedisit perreth drejt mjediseve te gjeberuara, nje mundesi e mire dhe per vadije dhe shmangie te derdhjes se tyre ne mjedis si dhe shmangie te perdorimit te ujit te pijshem per vadije.
- ✓ Jane ndermarre te gjitha masat e domosdoshme te mbrojtjes kundra zjarrit. Per te mbrojtur kunder zjarrit te mundshem qe mund te bjere do te ruhen largesite mbrojtese ndaj zjarrit te objektit dhe linjes se depozitimit te karburanteve.
- ✓ Aktiviteti i disponon infrastrukturen e nevojshme, me distancat e percaktuara per rruge kalim te punonjesve, automjeteve, zjarrefiksive, etj.
- ✓ Do te behet trajnimi periodik i punonjesve mbi kushtet e sigurimit teknik gjate operimit te punes, si dhe te kualifikohen stafi pergjegjes per operimin e punes ne objektin e magazinimit dhe furnizimit me karburant.